

Kombetarja/ Te enjten prova gjenerale para Bosnjes

nga AlbaniaSoccer
E martë, 31 Maj 2011 22:14



Josip Kuzhe do te provoje te gjithë lojtaret e tij ne nje ndeshje miqesore para se te niset per ne Bosnje. Kombetarja do te luaj kunder skuadres se Olimpikut nje ndeshje kontrolli ku Kuzhe do te provoje te gjitha idete e tij dhe do te behet gati per ndeshjen qe do te luhet ne 7 qershor ne Zenice. Miqesorja me Olimpikun do te zhvillohet ne 2 qershor, ne stadiumin Niko Dovana te Durrësit ne oren 17:30. Per momentin Kuzhe ka te grumbulluar 23 lojtare por ne Bosnje do te marre tre ose kater me pak. Te gjithë i ka te gatshem per momentin dhe te gjithë besojne se mund te marrin nje rezultat te mire ne kete ndeshje mjaft te veshtire.

Enea Shtrepi